

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

**MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË
BARABARTA**

DHE

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta e Republikës së Shqipërisë

dhe

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

Në vazhdim të referuara si “ **Palë**”,

Duke dëshiruar që të zhvillojnë marrëdhëniet ndërmjet dy institucioneve, me synimin për të siguruar të drejtën e çdo personi për: barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë, për mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, në fushën e veprimtarisë të cilën ato mbulojnë, kanë arritur mirëkuptimin si më poshtë vijon:

Kreu I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky Memorandum Bashkëpunimi siguron kuadrin brenda të cilit Palët do të zhvillojnë, marrëdhëniet ndërmjet tyre, për marrjen e masave për mbrojtjen nga diskriminimi në punësim, në fushën e shanseve të barabarta dhe familjes, migrimit të punës dhe mbrojtjes shoqërore.

Kreu II

FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

Neni 2

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e shanseve të barabarta dhe familjes

- 2.1. Palët do të bashkëpunojnë për marrjen e masave për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e shanseve të barabarta dhe familjes, bashkëpunim i cili konsiston në :

2.1.1 Shkëmbimin e kuadrit ligjor bazë në fushën e barazisë gjinore, të mbrojtjes së të drejtave të grave, fëmijëve, minoriteteve, personave me aftësi të kufizuara përfshirë mbrojtjen nga dhuna në familje, mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të gjinisë, orientimit të ndryshëm seksual, apo përkatësisë në një minoritet të caktuar;

2.1.2. Shkëmbimin e eksperiencës mbi politikat dhe programet në fushën e barazisë gjinore, mbrojtjes së të drejtave të grave dhe fëmijëve, të personave me aftësi të kufizuara, mbrojtjes nga dhuna në familje e nga diskriminimi për shkak të gjinisë, orientimit të ndryshëm seksual, etnisë, aftësisë së kufizuar;

2.1.3. Shkëmbim ekspertize për përmirësimin e legjislacionit në këtë fushë:

2.1.4. Shkëmbim ekspertize dhe organizim aktiviteteve të përbashkëta për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për mbrojtjen nga diskriminimi të grave, fëmijëve dhe personave që i përkasin minoriteteve, personave me aftësi të kufizuara, apo me orientim seksual të ndryshëm.

2.1.5. Shkëmbim informacioni, lidhur me ankesat e paraqitura përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ndjekjen e tyre, për diskriminimin me bazë gjininë, orientimin seksual, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një minoritet, apo për mosrespektim të të drejtave të fëmijëve.

Neni 3

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit

- 3.1. Palët do të bashkëpunojnë për marrjen e masave për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e punësimit, bashkëpunim i cili konsiston në :

3.1.1 Shkëmbimin e kuadrit ligjor bazë dhe të dhënave të tjera lidhur me garantimin e të drejtës për punësim, formimin profesional të çdo personi dhe anëtarësimin në organizatat sindikale;

3.1.2. Shkëmbim ekspertize për përmirësimin e legjislacionit të punës, me synim shtimin e masave për mbrojtjen nga diskriminimi, në punësim, formim profesional, apo për shkak të anëtarësimit në organizata sindikale;

3.1.3. Shkëmbim ekspertize dhe organizim aktivitetesh për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për mbrojtjen nga diskriminimi në punësim, sipas përcaktimeve të kreut II të ligjit nr.10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;

3.1.4. Shkëmbim informacioni, lidhur me ankesat e paraqitura përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ndjekjen e tyre, për diskriminimin në fushën e punësimit, apo për rastet që pretendohet që është kryer shqetësim seksual.

Neni 4

Mbrojtja nga diskriminimi i personave të huaj të punësuar/vetëpunësuar në Shqipëri

4.1. Palët do të bashkëpunojnë për marrjen e masave për mbrojtjen nga diskriminimi të personave të huaj të punësuar/vetëpunësuar në Shqipëri, bashkëpunim i cili konsiston në :

4.1.1 Shkëmbimin e kuadrit ligjor bazë dhe të dhënave të tjera lidhur me trajtimin e barabartë dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të huaj të punësuar/vetëpunësuar në Shqipëri;

4.1.2 Shkëmbim ekspertize për përmirësimin e legjislacionit me qëllim garantimin e të drejtave dhe detyrimeve të personave të huaj të punësuar/vetëpunësuar në Shqipëri;

4.1.3. Shkëmbim informacioni, lidhur me ankesat e paraqitura përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ndjekjen e tyre, për diskriminimin e personave të huaj të punësuar/vetëpunësuar në Shqipëri.

Neni 5

Mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e mbrojtjes shoqërore

- 5.1.. Palët do të bashkëpunojnë për marrjen e masave për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e mbrojtjes shoqërore, bashkëpunim i cili konsiston në:
- 5.1.1. Shkëmbimin e kuadrit ligjor bazë dhe të dhënave të tjera lidhur me kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë ndihmën ekonomike, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazhi tjetër social të ofruar për publikun, me qëllim përmirësimin e legjislacionit në këtë fushë;
 - 5.1.2. Shkëmbim ekspertize mbi politikat dhe programet ekzistuese, në fushën e mbrojtjes sociale;
 - 5.1.3. Shkëmbimin e ekspertizës mbi organizimin dhe administrimin e praktikave që ndiqen për sistemin e mbrojtjes shoqërore, lidhur me grupet në nevojë;
 - 5.1.4 Organizim aktivitetesh për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për përfitimet e shërbimeve shoqërore mbrojtjen nga diskriminimi në punësim, sipas përcaktimeve të shkronjës “c”, të nenit 20 të ligjit nr.10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;
 - 5.1.5. Shkëmbim informacioni, lidhur me ankesat e paraqitura përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ndjekjen e tyre, për diskriminimin për përfitim nga shërbimet shoqërore që ofrohen sipas legjislacionit të mbrojtjes shoqërore.

Kreu III

FORMAT E BASHKËPUNIMIT

Neni 6

Për mbrojtjen nga diskriminimi në fushat e veprimtarisë së MPCSSHB

- 6.1. Format e bashkëpunimit për mbrojtjen nga diskriminimi në fushat e veprimtarisë së MPCSSHB mund të përfshijnë:
 - 6.1.1. shkëmbim informacioni dhe njohurish
 - 6.1.2. organizim i fushatave të përbashkëta të sensibilizimit të publikut ;
 - 6.1.3. shkëmbim ekspertize, nëpërmjet kryerjes së studimeve apo analizave të përbashkëta, me synim evidentimin e problemeve për target grupet e grave, fëmijëve, personave me orientim seksual të ndryshëm, personave nga minoritetet , personave me aftësi të kufizuara, punëmarësve, grupeve të tjera në nevoje;
 - 6.1.4. shkëmbim ekspertize, nëpërmjet zhvillimit të tryezave të përbashkëta të diskutimit, edhe me aktorët përgjegjës për forcimin e zbatimit të legjislacionit në nivel vendor;
 - 6.1.5. organizime takimesh të përbashkëta, me pjesëmarrjen edhe të partnerëve socialë, me qëllim ndërgjegjësimin e punëdhënësve dhe punëmarrësve për detyrimet që rrjedhin nga ligji për mbrojtjen nga diskriminimi;
 - 6.1.6. shkëmbim ekspertize për përmirësimin e legjislacionit ekzistues, me qëllim përfshirjen e masave të reja që garantojnë trajtimin e barabartë të të huajve që punojnë në Shqipëri, dhe eliminimin e parashikimeve diskriminuese nga legjislacioni aktual;
 - 6.1.7. forma të tjera të bashkëpunimit për të cilat mund të bihet dakort.
 - 6.1.8. Secila prej palëve do të emërojë një përfaqësues, në cilësinë e personit të kontaktit, për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit, sipas formave që përcaktohen nga ky Memorandum.

Kreu IV

HYRJA NË FUQI DHE KOHËZGJATJA


Neni 8

1. Ky Memorandum Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Palët.
2. Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshohet në çdo kohë nga palët, në bazë të konsensusit të shprehur me shkrim.
3. Secila nga palët mund të përfundojë Memorandumin duke dërguar një njoftim paraprak me shkrim në adresë të palës tjetër të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara datës në të cilën kërkohet përfundimi i këtij Memorandumi Bashkëpunimi.
4. Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet sot, më datë 05 / 01 / 2012, në 2 (dy) kopje, një për secilën palë.


**PËR MINISTRINË E
PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA**

**PËP KOMISIONERIN
PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

SPIRO KSERA



MINISTËR



IRMA BARAKU



KOMISIONER



05.01.2012
Faqe 1/2